

ARGUMENTUM

news opinion analysis



**SAMITI I PROCESIT TË BERLINIT
PËR HERË TË PARË NË TIRANË**

**Rama: “Mirë se
erdhët në Evropën
e Re të Ballkanit”**

- Hamasi nis sulm të befasishëm ndaj Izraelit/ Netanyahu: Jemi në luftë!

- Xi Jinping stresses cooperation, development on new journey toward another “golden decade” for BRI

- Një luftë e papritur përmbys diplomacinë dhe politikën

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online. Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 POLITIKË | SHQIPËRI

- Speciale/Samiti i Procesit të Berlinit për herë të parë në Tiranë

09 JO VETEM LAJMI

- Hamasi nis sulm të befasishëm/ Kryeministri Netanyahu thotë se Izraeli “në luftë”

12 FOKUS

- Një luftë e papritur përmbys diplomacinë dhe politikën

14 POLITIKË | SHQIPËRI

- Presidenti Begaj pret homologun e tij Francez, Emmanuel Macron

15 RAJON

- Presidenti i Kroacisë, Zoran Milanović: Jam i vetmi joshqiptar, që bëj thirrje për njohjen e shtetit të Kosovës

- Liderët evropianë: Kosova t’i nisë procedurat për asociacionin, Serbia njohjen “de facto”

- Mali i Zi, zgjidhet qeveria e re e kryeministrit Miloško Spajić

- Ursula von der Leyen në Shkup: Ndryshimet kushtetuese, të domosdoshme për anëtarësim në BE-në

ENGLISH EDITION

21 ENGLISH TOP NEWS

- Berlin Process summit held in Tirana as PM Rama says its economic promises haven’t been realized

22 CURRENT EVENTS

- ‘We are at war,’ Netanyahu says, after Hamas launches devastating surprise attack

- Albania abstains from the resolution approved by the UN for the cessation of fighting in Gaza

5 IN FOCUS

- President of France tells Albania that its future is in Europe during his official visit in Tirana

27 REALPOLITIK

- The whole Brussels in Kiev! The third but not the true! Heads high, hands empty! Terrorist Hamas, a democratic and diplomatic failure! Berlin marked the end of absurd dualism!

30 GLOBAL

- Xi Jinping stresses cooperation, development on new journey toward another “golden decade” for BRI

SPECIALE

SAMITI I PROCESIT TË BERLINIT PËR HERË TË PARË NË TIRANË



Tirana mikpret sot (16.10) një tjetër event të madh ndërkombëtar, *Samitin e Liderëve të Procesit të Berlinit 2023*, i cili zhvillohet për herë të parë jashtë kufijve të BE-së, me pjesëmarrjen e 6 kryeministrave të rajonit, si dhe përfaqësuesve të nivelit të lartë dhe organizmave ndërkombëtare të mbi 25 vendeve, mes të cilëve Kancelari i Gjermanisë Olaf Scholz, Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, Presidenti i Këshillit Evropian Charles Michel, si edhe një sërë kryeministrash të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Edicioni i ri i procesit të Berlinit, i cili u mbajt sot në Tiranë, për herë të parë në një vend jo anëtar të BE-së, i përfshirë në procesin e

integritetit të komunitetit. Samiti u nis në vitin 2014 nga kancelarja gjermane e atëhershme Angela Merkel me qëllim të promovimit të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe mbështetjes së perspektivës së tij evropiane. Samiti një Tiranë, i fokusuar në propozimet konkrete për ta afruar rajonin gjithnjë e më shumë me BE-në në funksion të zgjerimit, pa praninë, si dhe kryeministrin shqiptar Edi Rama, të kreut të qeverisë maqedonase Dimitar Kovačevski, të atij kosovar kryeministrit Albin Kurti, i kreut të qeverisë malazeze Dritan Abazovic, i kryeministrit kroat Andrej Plenkovic, kryeministrja serbe Ana Brnabic dhe kryeministrja boshnjake Borjana Kristo, si dhe kancelarja

gjermane Olaf Scholz, e Presidentit të Komisionit Evropian Ursula von der Leyen dhe Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel.

Pjesëmarrësit në Samit u mikpritën nga Kryeministri Edi Rama në një ceremoni të posaçme në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” e më pas vijuan në mjediset e COD (Qendra për Hapje dhe Dialog) në Kryeministri, ku ndoqën një performancë baleti të koreografit shqiptar me famë botërore Angjelin Preljocaj, e cila illustroi ekspozimin e pikturës “Rrëmbimi i Europës” (Abduction of Europa), të piktorit italian Giovanni Domenico Cerrini.

“Mirë se erdhët të gjithë! Men-



Kryeministri Shqiptar, **Edi Rama**

Kemi një sulm shkatërrues kundrejt Izraelit. Jemi solidar me Izraelin por përhapja e tmerrshme e urrejtjes dëshmon se pikëpamje të ndryshme rreth botës po krijojnë dasi. Si po reagojmë ne ndaj kësaj skene që zhvillohet përtej kufjeve tanë? Ndërkohë që ne jemi të bashkuar kundër veprimeve të Rusisë në Ukrainë a po përgatisim një përgjigje për sfidat që kemi para?

dova se ishte vendi i duhur, momenti i duhur për të ekspozuar “Rrëmbimi i Europës”, kryeveprën e Giovanni Domenico Cerini, – iu drejtua të pranishmëve Kryeministri Rama.

Në nisje të Samitit, i cili po zhvillohet në ndërtesën e transformuar të Piramidës në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, liderët, Kryeministri Edi Rama, Kancelari i Gjermanisë Olaf Scholz, Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, Presidenti i Këshillit European Charles Michel, si dhe Kryeministri i Spanjës Pedro Sanchez iu adresuan Samitit me një fjalë përshëndetëse.

Seanca “Integrimi i Rajonit në Tregun Unik dhe përmirësimi i Konvergencës me BE-në” do të çelë punimet e Samitit, i cili do të vijojë me seancën e dytë

plenare “Mbështetja e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital në Ballkanin Perëndimor: Sfidat dhe mundësitë për investime dhe zhvillim.” ku liderë dhe kryetarë delegacionesh do t’i adresohen të dy seancave.

Rama iu drejtua samitit i cili po zhvillohet në ndërtesën e transformuar të Piramidës në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, duke u shprehur se “disa nga përfaqësuesit e vendeve këtu janë nga BE disa të tjerë, si ne, janë nga ‘E’ pa ‘B’. Por të gjithë ne besojmë fort në nevojën e një çatie të përbashkët, tryeze të bashkëndarë dhe një llogorje të përbashkët në këto kohë sprove që duken se do të përkeqësohen para se të përmirësohen”.

Kryeministri theksoi se një luftë në prag të Europës na ka treguar se bota po ndryshon shumë më

shpejt dhe ndryshe nga sa e kemi parashikuar shumica prej nesh.

“Kemi një sulm shkatërrues kundrejt Izraelit. Jemi solidar me Izraelin por përhapja e tmerrshme e urrejtjes dëshmon se pikëpamje të ndryshme rreth botës po krijojnë dasi. Si po reagojmë ne ndaj kësaj skene që zhvillohet përtej kufjeve tanë? Ndërkohë që ne jemi të bashkuar kundër veprimeve të Rusisë në Ukrainë a po përgatisim një përgjigje për sfidat që kemi para?”, tha Rama. Sipas tij, “ka shumë sfida përpara por për të gjithë ne këtu, sfida më e madhe është ndarja e dhimbshme mes anëtarëve të BE-së dhe jo anëtarëve të BE-së”.

“Të jetosh pa BE-në nuk është e lehtë”, shtoi ai.

“Ndërkohë që ju të gjithë jeni të ndërgjegjshëm për këtë unë nuk do të drejtoj gishtin ndaj askujt, por dua të ngre disa pikëpyetje. A mund të përballojmë këto ndasi mes vendeve të BE-së dhe vendeve jo në BE? 9 vjet më parë kur nisi Procesi i Berlinit në 2014 udhëheqësit e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor u bashkuan për herë të parë në historinë e fqinjësisë sonë për t’u nisur në një rrugëtim bashkëpunues drejt një objektivit domethënës për transformimin e këtij rajonit në një zonë që pasqyron 4 liritë e BE-së. Gjatë këtyre 9 viteve kemi dëshmuar se si edhe midis nesh, ne u bëmë pionierë të iniciativave në Ballkanin Perëndimor që do të kishin qenë të pakonceptueshme pa Procesin e Berlinit. Në këto 9 vite ne kemi përfituar mjaft përvojë duke shkëmbyer mjaft pikëpamje”, theksoi Rama.

Kryeministri vlerësoi se “futja e kësaj fryme e kombinimi në frymën e rajonit është një arritje e

madhe e Procesit të Berlinit dhe kësaj nisme vizionare”.

Por vijoi ai, “premtimet ekonomike të Procesit të Berlinit nuk janë realizuar plotësisht, sidomos kur krahasohet kjo edhe me mendësinë transformuese që ka sjellë ky proces”.

“Merkel e theksoi këtë në takimin e Polonisë. Ajo tha se demokracia pa infrastrukturë nuk mund të funksionojë si duhet”, theksoi ai.

Sipas kryeministrit Rama, megjithatë, premtimet ekonomike të Procesit të Berlinit “nuk janë realizuar ende plotësisht”.

Siç vërejtí Rama, ndër burimet e akorduara nga Brukseli, “vetëm 10 për qind janë grante, pasi 90 për qind e mbetur kanë të bëjnë



me kredi” dhe procedurat për aksesin në fondet janë “të vjetruara dhe të ngadalta”. “Fqinjët tanë në Bashkimin Evropian marrin më shumë se 4500 euro për frymë, ndërsa vendet tona marrin 138 euro për frymë”, tha kryeministri shqiptar. Këto të dhëna janë prova e parë e shtrirjes së frikshme të një hendeku që ka kontribuar progresivisht në rritjen e ndarjes sonë në vetë shtëpinë europiane, në një vit në të cilin krizat transversale kanë goditur kontinentin”, nënvizoi Rama, duke shpresuar se divergjencat, ndërmjet rajonit dhe vendeve anëtare të BE-së mund të zbutet. Të njëjtin

koncept nënvizoi von der Leyen, e cila nënvizoi se ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së janë “ende shumë të largëta”. Përgatitjet për anëtarësim, të shpresuara deri në vitin 2030, tha presidenti i Komisionit Evropian, “ende nuk janë aty ku do të donim të ishin”.

Duke vlerësuar planin e ri ekonomik, Rama theksoi se tashmë po ndërmarrim hapa domethënës për ndryshime kryesore politike dhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor.

“Ky është hapi i parë i guximshëm pas përsëritjeve dëshpëruese të të marrit me një sërë dokumentesh. Tashmë jemi në pikën kur diskutojmë për ekonominë”, theksoi Rama.

Presidentja e Komisionit Evropianë, Ursula Von Der Leyen, në çelje të Samitit të Procesit të Berlinit, që u zhvillua në Tiranë, bëri apel për bashkëpunim të plotë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE, me qëllim që ky rajon të kthehet sa më shpejt në zemër të Bashkimit Evropian.

Von Der Leyen, nënvizoi se Bashkimi Evropian ka nevojë për miqtë e saj në Ballkanin Perëndimor.

“Vetëm duke punuar së bashku, do të bëjmë të mundur që Ballkani Perëndimor të vijë aty ku meriton, në zemër të Bashkimit Evropian. Këto janë momente kyçe, momente të rëndësishme vendimmarrëse, mos i lini mundësitë t’ju shpëtojnë, kapeni momentin”, bëri apel Von Der Leyen.

Po ashtu, zyrtarja e lartë e Bashkimit Evropianë, vlerësoi si mjaft të rëndësishëm çeljen e programit master në Kolegjin e Evropës që do të zhvillohet në Tiranë nga



Presidentja e Komisionit Evropianë,
Ursula Von Der Leyen

“Vetëm duke punuar së bashku, do të bëjmë të mundur që Ballkani Perëndimor të vijë aty ku meriton, në zemër të Bashkimit Evropian. Këto janë momente kyçe, momente të rëndësishme vendimmarrëse, mos i lini mundësitë t’ju shpëtojnë, kapeni momentin”,

viti i ardhshëm akademik.

“Dje lançua programin e Kolegjit të Evropës. Studentët do të vijnë nga Shqipëria, Ballkani dhe e gjithë Europa do të kenë një mundësi të artë për të mësuar se si punohet në Bashkimin Evropian, për të qenë më afër me BE. Ky është një mesazh shumë i rëndësishëm”, shtoi Von Der Leyen.

Bashkëpunimi ekonomik, sipas saj, është kryefjalë e Procesit të Berlinit.

“Ky proces nisi në vitin 2014. Synimi ishte për të ecur përpara në rajon dhe për të forcuar bashkëpunim rajonal ekonomik. Kemi hedhur themele të forta me planin tonë të investimit ekonomik prej 30 miliardë euro. 16 miliardë euro janë përdorur tashmë”, tha Von Der Leyen.

Presidentja e Komisionit Evropianë shtoi se BE dëshiron të hapi dyert e tregut të saj për Ballkanin

Perëndimor, por për këtë duhen plotësuar kushtet nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

“Dua t’ju them se sa herë kemi patur zgjerim, vendet jo anëtare të BE pas anëtarësimit kanë patur rritje ekonomike, po ashtu edhe vetë tregu evropian është zhvilluar, pasi është bërë më i madh. Ne duam të hapim për vendet e Ballkanit Perëndimor në tregun evropian, lëvizja e lirë e mallrave, njerëzve dhe shërbimeve, tregu digjital, shërbimet, pagesat pa para në dorë, për ta bërë më të lehtë dhe për të patur transaksionet si në BE”, shtoi Von Der Leyen.

Kancelari i Republikës Federale të Gjermanisë, Olaf Scholz, deklaroi sot se përshkallëzimet e kohëve të fundit në veri të Kosovës kanë vërtetuar sa i rëndësishëm është bashkëpunimi mes Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian.

Në fjalën e tij në Samitin e Berlinit, që po mbahet në Tiranë, Scholz theksoi se “ne duhet të përfundojmë më në fund zbatimin e marrëveshjeve që janë arritur me anë të dialogut të normalizimit të udhëhequr nga BE-ja”.

“Shqipëria njihet për mikpritjen dhe kjo është vërtetuar edhe njëherë sot. Ne e kemi kuptuar edhe kur kemi pasur takimin e Këshillit Evropian. Për takime të shumta të nivelit të lartë e ministriale në kuadër të procesit të Berlinit. Kanë qenë efikase e të përgatitura shumë mirë. E mbaj mend shumë mirë kur u takuam vjet në Berlin dhe të gjithë ramë dakord që Procesi i Berlinit është instrumenti më i mirë jo vetëm që të çlirohet potenciali i plotë i bashkëpunimit rajonal, por edhe



Kancelari i Republikës Federale të Gjermanisë, **Olaf Scholz**

E mbaj mend shumë mirë kur u takuam vjet në Berlin dhe të gjithë ramë dakord që Procesi i Berlinit është instrumenti më i mirë jo vetëm që të çlirohet potenciali i plotë i bashkëpunimit rajonal, por edhe për të përshpejtuar integrimin në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor”,

për të përshpejtuar integrimin në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor”, tha Scholz.

Kancelari Scholz u shpreh se “ky vlerësim është po aq i vërtetë sot sa ka qenë edhe vjet. Procesi i Berlinit është një forum bashkëpunimi, kur bashkëpunimi është i nevojshëm, pra kërkohet më shumë se kurrë. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës edhe një herë ka treguar se sa e rëndësishme është që në të flasim me një zë të vetëm evropian dhe që ne të bashkëpunojmë edhe më tej”.

Duke iu drejtuar Kryeministrit Rama, Scholz tha se “siç e përmendet edhe ju në fjalimin tuaj është shumë e qartë që fakti që ne jemi të ulur këtu, ne dimë që kemi një situatë të re, shumë të vështirë, jo shumë larg nesh, që po ndodh tashmë me agresionin

e Hamasit kundër Izraelit dhe të gjitha pasojat që ka dhe mund të ketë. Edhe krizat e shumëfishta në rajon në Ballkanin Perëndimor kanë theksuar nevojën urgjente për të punuar më shumë së bashku dhe për të tejkaluar antagonizmat”.

Ka ardhur koha, shtoi Scholz, për të tejkaluar konfliktet, të cilat kanë vijuar për shumë më gjatë dhe që në fakt ju kanë mbajtur dhe vetëm ju mbajnë juve, në vendnumëro.

“Jam shumë i kënaqur që për herë të parë ky samit organizohet në një vend të Ballkanit Perëndimor. Është një sinjal i fortë dhe thekson edhe pronësinë që ka rajoni në këtë proces dhe ne duhet ta përdorim këtë rast për t’u përqendruar tek objektivi që kanë të gjitha shoqëritë e Ballkanit Perëndimor dhe ky është integrimi brenda për brenda rajonit dhe ecuria e mëtejshme në rrugëtimin drejt BE-së. Vitin e shkuar ju keni marrë disa hapa madhorë në lidhje me nënshkrimin e 3 marrëveshjeve të lëvizshmërisë dhe jam mirënjohës që 4 nga 6 shtete i kanë ratifikuar këto marrëveshje deri tani”, nënvizoi Scholz.

“Çfarëdolloj ecurie që do të kemi për tregun e përbashkët rajonal është më konkret se kurrë. Mund të mbështeteni tek ne, tek Gjermania. Ky është Procesi i Berlinit”, përfundoi Scholz.

Në samit merr pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe mugon ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiç. E pranishme është presidentja e Serbisë Ana Brnabiç.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën e tij solli në vëmendje ndikimin pengues që sjellin në procesin e bashkëpunimit rajonal konfliktet dypalëshe.

Një samit me mungesa

Ky samit, i pari në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nuk u përfaqësua nga çdo vend. Përshembull, nga Ballkani mungon Aleksandër Vuçiç, pasi ndodhet në Kinë, ku do të marrin pjesë në Forumin e tretë "Brez dhe rrugë" që nis të martën në Pekin. Në vend të tij, ishte Kryeministrja e Serbisë Ana Brnabiç. Ajo u prit nga Rama, ku pati edhe një shtrëngim duarsh. Gjithashtu dhe nga Europa, pati zëvendësime ose ndryshim axhendë. Nga Italia, mungoi Meloni. Ndërsa Macron, mungoi në samit, duke zhvendosur me disa orë vizitën e tij në Tiranë.

PRITJA NË PIRAMIDËN E ENVER HOXHËS

Një dokumentar që flet për historinë e Shqipërisë që nga shpallja e pavarësisë më 1912, përballja me diktaturën dhe rindërtimi i Tiranës, është shfaqur para liderëve të Bashkimit Evropian me narracion të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama.

Liderit evropian po bëjnë një takim për herë të parë në godinën propagandistike të komunizimit tha Rama.

"Evropa sot ka tjetër dinamikë, me një luftë brenda vetes", shtjelloi kryeministri shqiptar, duke i dhënë zë sërish agresionit rus në Ukrainë dhe se si ai ka ndryshuar edhe qasjen evropiane karshi rajonit.

Ky në fakt është edhe qëllimi kryesor i Procesit të Berlinit, të cilin vetë Rama e përmend qat

rtësisht: Të hidhet një hap i madh për Ballkanin, drejt rrugëtimit të përbashkët bashkëpunues.


Është ky në fakt çelësi i integritimit sa duket, edhe në retorikën evropiane.

"Krijoni BE-në brenda vetes, që të jeni më pranë anëtarësimit integral".

Ky ka qenë qëllimi fillestar i Procesit të Berlinit, i cili sot vijon, pas 10 takimesh, dhe për herë të parë del nga kufijtë evropianë.

"Qëndrojmë këtu si anëtarë të barabartë të komunitetit politik evropian", vijon ai. "Disa nga ju janë nga BE (Bashkimi Evropian), ne jemi vetëm nga E (Evropa).

"Mirë se erdhët në Evropën e Re të Ballkanit", përfundon Rama, duke u uruar mirëerdhje përfaqësuesve të shteteve të BE-së.



Tirana was the most isolated capital

Çfarë u arrit ne këtë samit të dhjetë të Procesit të Berlinit?

Në kuadër të samitit të Procesit të Berlinit që po mbahet në Tiranë, u firmos marrëveshja ndërmjet liderëve të Ballkanin Perëndimor, për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore, (CEFTA). Vitin e kaluar u njohën mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve.

Perpos nenshkrimit të “Marrëveshjes Rajonale për Njohjen Reciproke të Kualifikimit Profesional.

Deklaratave permbyllesse të Presidentes së Be-se Ursula von der Leyen dhe Kancelarit gjerman Scholz, pjesa tjetër e arritjeve të këtij samiti ishin thjesht ceremoniale.

Inaugurimi i Kolegjit të Europës, i cili hap dyert për një arsimim të nivelit botëror për studentët shqiptarë, është një tjetër ngjarje e rëndësishme në këtë ditë. Kampusi i Tiranës është i treti i Kolegjit të Europës dhe i pari që do të jetë jashtë Bashkimit Evropian.

Në ditën e Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit 2023, hapi dyert në Tiranë, Kolegji i Europian i Bryzhit (Bruges), Belgjikë me të parin kampus jashtë vendeve të



Bashkimit Evropian,

Zyra e re përfaqësuese e Kolegjit të Europës do të jetë e vendosur në mjediset e reja të Piramidës. Ajo u përrurua sot në praninë e Kryeministrit Edi Rama, Presidentes së Komisionit Europian, Ursula Von Der Leyen, Presidentit të Këshillit Europian Charles Michel, Rektores së Kolegjit të Europës Federica Mogherini, si edhe të liderëve të tjerë të pranishëm në Samit.

Në përmblyllje të ditës së Samitit, të gjithë pjesëmarrësit ishin pjesë e ceremonisë së inaugurimit të infrastrukturës së re të Piramidës.

Piramida, e cila u shndërrua sot në simbolin e mikpritjes së Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit 2023, është transformuar në destinacionin më të madh të teknologjisë digjitale në rajon.

Procesi i Berlinit është një platformë bashkëpunimi e nivelit të lartë mes 6 vendeve të Ballkanin Perëndimor të përbërë nga Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, dhe vendeve anëtare të BE, që synon rritjen e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe dhënien e ndihmës për integrimin e vendeve të këtij rajoni në Bashkimin Evropian. Procesi përfshin gjithashtu institucionet e BE-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë

Procesi i Berlinit është një iniciativë që synon rritjen e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe dhënien e ndihmës për integrimin e vendeve të BP në Bashkimin Evropian. Ai filloi dhe u prezantua në 28 Gusht 2014, nga Kancelarja Gjermane Angela Merkel. Qëllimet e Procesit u përshkruan në Deklaratën Përfundimtare nga Kryesia Gjermane:

“Të bëjmë progres shtesë real në procesin e reformës, në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura bilaterale dhe të brendshme dhe në arritjen e pajtimit brenda dhe midis shoqërive në rajon”, si dhe të rrisim “bashkëpunimin ekonomik rajonal dhe të hedhim bazat për një rritje të qëndrueshme”, deklaroi Merkel asokohe.

MINORITETET NË SHQIPËRI JAPIN NGJYRA HARMONIE PËRA LIDERVE EUROPIANE DHE BALLKANIKË



Mikpritja dhe tradita shqiptare u shpaleshën para liderve europiane dhe ballkanikë, duke sjellë një buqetë të bukur folklori me muzikë dhe vallet karakteristike të grupeve minoritare në Shqipëri. Kështu, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Serbia, Greqia, minoriteti Rom, dhe Shqipëria si vend mikpritës dhuruan disa minuta nga tradita e Ballkanit.

HAMASI NIS SULM TË BEFASISHËM

Kryeministri Netanyahu thotë se Izraeli “në luftë”



Grupi islamik palestinez Hamas nisi të shtunën sulmin më të madh ndaj Izraelit në vite, duke vrarë të paktën 200 njerëz dhe duke pretenduar se kishte marrë dhjetëra pengje në një sulm të befasishtëm, duke kombinuar persona të armatosur që kalonin në Izrael dhe një breshëri raketash të lëshuara nga Gaza.

Izraeli tha se grupi i mbështetur nga Irani kishte shpallur luftë ndërsa ushtria e tij konfirmoi luftimet me militantët në disa qytete dhe baza ushtarake izraelite pranë Gazës dhe kryeministri Benjamin Netanyahu u zotua të hakmerret.

Raportet e hershme tregojnë se 2500 raketa u qëlluan mbi Izraelin nga Rripi i Gazës, duke arritur deri në Jerusalem dhe Tel Aviv.

Në të njëjtën kohë u dëgjua shpërthimi i zjarrit kundër raketave “Iron Dome”, teksa u kapën raketa arabe.

Dhjetëra mijëra personel rezervë të ushtrisë izraelite do të mobi-

lizohen.

Ka gjithashtu raporte se disa trupa rezervë që marrin pjesë në lëvizjen protestuese kundër qeverisë Netanyahu po kthehen në detyrë rezervë pas sulmeve.

Mediat po raportojnë më tej sulme ndaj pozicioneve të Hamasit në Rripin e Gazës nga avionët luftarakë izraelitë.

”Armiku do të paguajë një çmim që nuk e ka njohur kurrë”, deklaroi kryeministri izraelit, Netanyahu

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, gjatë një adresimi televiziv më 7 tetor tha se Izraeli është “në luftë”, pas sulmit



masiv që militantët e Hamasit nisën më herët gjatë ditës.

“Ne jemi në luftë”, tha Netanyahu. “Nuk është ‘operacion’, por luftë”.

Shërbimi kombëtar i shpëtim-it në Izrael tha se të paktën 40 persona janë vrarë dhe qindra të tjerë janë plagosur si pasojë e dhunës.

Ministria palestineze e Shëndetësisë tha se të paktën 198 persona janë vrarë në Gaza dhe mbi 1.600 të tjerë janë plagosur gjatë dhunës.

Grupi militant Hamas tha se ka lëshuar mijëra raketa në Izrael mëngjesin e 7 tetorit, duke nxitur autoritetet që të lëshojnë alarme për sulme ajrore në mbarë vendin, përfshirë në Jerusalem dhe Tel Aviv. Izraeli u kundërpërgjigj duke kryer sulme ajrore ndaj caqeve në Rripin e Gazës.

Luftëtarët e Hamasit po ashtu kanë kaluar kufirin e fortifikuar dhe kanë hyrë në Izrael, duke u përleshur me forcat e mbrojtjes së Izraelit në të paktën shtatë lo-



Reagimi ndërkombëtar

Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Spanja, Gjermania dhe shtetet e tjera kanë lëshuar deklarata duke afirmuar të drejtën e Izraelit për të mbrojtur veten dhe kanë bërë thirrje për armëpushim.

SHBA-ja tha se e dënon sulmin nga “terroristët e Hamasit”, duke shtuar: “Ne qëndrojmë me Qeverinë dhe popullin e Izraelit”.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha se Pentagoni do të punojë për t’u siguruar që Izraeli “ka atë që i duhet për të mbrojtur veten”.

Ndërkaq, deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Francës u dënuan “sulmet terroriste që po vazhdojnë” dhe Parisi shprehu “solidaritetin e plotë me Izraelin dhe viktimat e këtyre sulmeve”. Ndërkaq, Spanja dënoi “dhunën” kundër Izraelit. Një këshilltar i liderit suprem të Iranit tha se shteti i tij mbështet “operacionin krenar”, raportoi agjencia e lajmeve

ISNA. Gjatë një sesioni plenar më 7 tetor, ligjvënësit iranianë mbrohoritën “Poshtë Izraeli” dhe “Poshtë Amerika”.

Në Liban, grupi militant Hezbollah lavdëroi Hamasin dhe tha se sulmi ndaj Izraelit ka “mbështetje hyjnore”.

Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Rusia u kanë bërë thirrje të dyja palët të tregojnë përmbajtje. Zëvendësministri i Jashtëm rus, Mikhail Bogdanov, bëri thirrje për “një armëpushim të menjëhershëm dhe paqe”.

Izraeli ka mbajtur një bllokadë strikte në Gaza që kur Hamasi mori territorin në vitin 2007. Kufizimi i lëvizjes së mallrave dhe njerëzve ka shkatërruar ekonominë në Gaza, por Izraeli ka thënë se bllokada është e nevojshme për të parandaluar që armët të arrijnë te grupet militante.

Izraeli ka pushtuar Bregun Perëndimor më 1967 gjatë luftës gjashtëditore.

kacione në jug të Izraelit.

Hamasi lëshoi një deklaratë, duke thënë se mbi 5.000 raketa janë lëshuar në atë që e ka quajtur “Operacioni Përmbytja Al-Aksa”.

“Ne kemi vendosur t’i japim fund të gjitha krimeve të pushtimit”, u tha në deklaratë. “Koha e tyre për të kryer krime pa u mbajtur përgjegjës ka mbaruar”.

Dhjetëra avionë luftarakë izraelitë raportohet se kanë kryer operacione mbi Gaza, përderisa zyrtarët izraelitë deklaruan se kanë shënjestruar caqe ushtarake dhe qendrat e komandës së Hamasit.

Sulmi vjen në kohën kur në Iz-



rael po shënohet një festivali fetar bebrej.

Gjatë një adresimi televiziv, ministri i Mbrojtjes së Izraelit, Yoav Gallant, tha se Hamasi ka bërë “një gabim të madh” dhe u zotua se “shteti i Izraelit do ta fitojë këtë luftë”.

Netanyahu ka urdhëruar “mobilizimin e gjerë të rezervistëve”. “Armiku do të paguajë me një

çmim të paprecedent”, tha ai.

Miliona izraelitë janë strehuar pas lëshimit të alarmeve në qytetet në mbarë shtetin.

Presidenti palestinez Mahmoud Abbas të shtunën theksoi të drejtën e popullit të tij për të mbrojtur veten, sipas agjencisë zyrtare të lajmeve palestineze Wafa.

Gjatë një takimi urgjent me zyrtarë të lartë civilë dhe të sigurisë, presidenti palestinez urdhëroi mbrojtjen e nevojshme për njerëzit, duke theksuar të drejtën e popullit palestinez për të “mbrojtur veten kundër terrorizmit të kolonëve dhe forcave pushtuese”.

OKB bën thirrje për armëpushim në Gazë/ Guterres: Izraeli shkeli ligjin ndërkombëtar

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, pretendoi se ka pasur shkelje të ligjit ndërkombëtar teksa Izraeli sulmon nga ajri Gazën dhe bëri thirrje për një armëpushim të menjëhershëm humanitar.

“Jam thellësisht i shqetësuar për shkeljet e qarta të ligjit ndërkombëtar që ne po shikojmë në Gazë. Më lejoni të jemi i qartë: asnjë palë në një konflikt të armatosur nuk është mbi ligjin ndërkombëtar humanitar”, tha Guterres gjatë mbledhjes së Këshillit të Sigurimit, pa përmendur në mënyrë eksplicite Izraelin.

Ai ishte kritik dhe i drejtpërdrejtë ndërsa tha se “Sulmet e Hamasit kundër Izraelit nuk erdhën nga hiçi”, duke hapur takimin e posaçëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për krizën në Lindjen e Mesme.

“Populli palestinez i është nënshtruar pushtimit mbytës për 56 vjet. Ata e kanë parë tokën e tyre të gllabëruar vazhdimisht nga vendbanimet dhe të rrënuar nga dhuna; ekonomia e tyre u mbyti; njerëzit e tyre të zhvendosur dhe shtëpitë e tyre të shkatërruara. Shpresat e tyre për një zgjidhje politike të gjendjes së tyre janë zhdukur”.

Guterres shtoi se “ankesat e popullit palestinez nuk mund të justifikojnë sulmet e tmerrshme të Hamasit. Dhe këto sulme të tmerrshme nuk mund të justifikojnë ndëshkimin kolektiv të popullit palestinez. Deklarata këto që ngjallën zemërimin e Izraelit. Ambasadori izraelit në Kombet e Bashkuara, Gilad Erdan, i është përgjigjur numrit një të OKB-së, duke thënë se fjalët e tij janë “tronditëse”, “të tmerrshme” dhe “krejtësisht të shkëputura nga realiteti i rajonit tonë”.

“Komentet e tij... përbëjnë një justifikim për terrorizmin dhe vrasjen”, thotë Erdan. “Është e trishtueshme që një person me pikëpamje të tilla është kreu i një organizate që u ngrit pas Holokaustit”.

Ambasadori i Izraelit në OKB, Gilad Erdan kërkoi më tej dorëheqjen e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

“Unë e ftoj atë të japë dorëheqjen menjëherë. Nuk ka asnjë justifikim apo pikë për të folur me ata që



tregojnë mirëkuptim për aktet më të tmerrshme të kryera kundër qytetarëve të Izraelit – as më pak nga një organizatë e shpallur terroriste”, tha ai.

Guterres, që personalisht ka vizituar pikëkalimin mes Egjiptit dhe Gazës, në përpjekje për të mundur që ndihma të arrijë në Gazë përmes pikëkalimit Rafah. Këtë pikëkalim u lejuan që ta kalonin tre autokolona me ndihma.

“Por, kjo sasi e ndihmës është si një pikë ujë në oqean. Për më tepër, furnizimet me karburante të OKB-së në Gazë do të harxhohen brenda ditësh. Ajo do të jetë një fatkeqësi e re”, tha Guterres.

“Për të lehtësuar vuajtjet epike, për të bërë që ndihma të arrijë më lehtë dhe më sigurt, për të lehtësuar lirin e pengjeve, unë përsëris thirrjen time për një armëpushim të menjëhershëm humanitar”.

Militantët palestinezë të Hamasit më 7 tetor nisën sulme të koordinuara ndaj Izraelit duke vrarë të paktën 1.400 palestinezë dhe duke marrë mbi 220 pengje, kanë thënë autoritetet izraelite.

Mbi 5.700 palestinezë janë vrarë në Rripin e Gazës nga bombardimet hakmarrëse të Izraelit, ka thënë Ministria e Shëndetësisë në territorin që udhëhiqet nga Hamasi.

Një luftë e papritur përmbys diplomacinë dhe politikën

Sulmi i djeshëm militant palestinez ndaj Izraelit, ndoshta më vdekjeprurësi dhe më i madhi ndonjëherë, do të ndryshojë në mënyrë dramatike llogaritjet diplomatike dhe politike në Lindjen e Mesme dhe do të privojë Uashingtonin nga çdo levë që ka për të ndikuar në Izrael, thonë diplomatët dhe analistët.

Është e sigurt se Izraeli do të përgjigjet me një sulm të plotë frontal në Rripin e Gazës të sunduar nga Hamasi dhe ndoshta pjesë të Bregut Perëndimor, në atë që kryeministri Benjamin Netanyahu e ka quajtur tashmë një luftë të gjithanshme.

”Një inkursion tokësor, 18 vjet pasi Izraeli u tërhoq nga Gaza, nuk përjashtohet”, thonë ek-

spertët.

Pyetja e afërt dhe urgjente atëherë do të jetë nëse luftimet shtrihen më tej në rajon, duke përfshirë Libanin ose zona të tjera ku janë të vendosur militantët anti izraelitë, përfshirë Hezbollahun.

Ndërsa numri i të vdekurve të izraelitëve dhe palestinezëve u rrit në mënyrë të vazhdueshme dje, kapja e pengjeve të shumta izraelite nga militantët palestinezë të Hamasit që depërtuan në Izraelin jugor përbën një element të ri me pasoja të paparashikueshme.

Një tjetër viktimitë e menjëhershme e dhunës së paprecedentë do të jenë përpjekjet e mbështetura nga SHBA për të hapur marrëdhëniet midis Izraelit dhe Arabisë Saudite, një lëvizje shumë e çmuar dhe historike që po merrte vrull javët e fundit.

Për të nënshkruar marrëveshjen,

Arabia Saudite ka kërkuar një sërë lëshimesh nga SHBA-ja dhe Izraeli, duke përfshirë hapa që do t'i afronin palestinezët drejt krijimit të një shteti të pavarur.

Ky koncesion ka hasur rezistencë nga Netanyahu dhe qeveria e tij ultrakonservatore, edhe pse administrata Biden ka këmbëngulur në “zgjidhjen me dy shtete”, siç dihet.

“Çdo levë që kishte administrata Biden për të kërkuar lëshime nga Netanyahu për përmirësimin e kushteve për palestinezët është zhdukur plotësisht”, tha Aaron David Miller, një ish-i dërguar veteran në Lindjen e Mesme, tani në “Carnegie Endowment for International Peace”.

”Megjithëse, ndoshta nuk ka vdekur ende, normalizimi ka pësuar një goditje të rëndësishme”, theksoi ai.

“Ne nuk e dimë se ku po shkon e gjithë kjo, por gjakderdhja do





të rritet nga të gjitha anët”, shtoi Miller.

”I tronditur nga niveli i masakrës, do të ishte e pamundur në këtë pikë për çdo kryeministër izraelit të bënte lëshime ndaj palestinezëve”, thanë disa analistë.

Në mënyrë të ngjashme, numri i lartë i vdekjeve midis civilëve palestinezë do të komplikonte çdo hap që sauditët mund të kishin qenë të gatshëm të bënin ndaj Izraelit.

Sekretari i Shtetit Antony J. Blinken ishte planifikuar të udhëtonte në Izrael, qytetin palestinez të Ramallahut dhe Arabinë Saudite javën e ardhshme, por ai udhëtim tani mund të anulohet. Së paku, do të bëhet një mision i diplomacisë së krizës në vend të përpjekjeve për të bërë përparim në hapjen e lidhjeve Izrael-Arabi Saudite.

Në Uashington, ndërkohë, Shtëpia e Bardhë u alarmua.

Blinken iu bashkua presidentit

Joe Biden dhe zyrtarëve të tjerë të lartë të sigurisë kombëtare për takime urgjente.

”Blinken po telefonon liderët botërorë në një përpjekje për të vendosur mbi një kurs veprimi”, tha një zëdhënës i Departamentit të Shtetit.

Dënimi i SHBA-së për sulmin masiv të befasishëm ishte uniform dhe universal.

Edhe qeveritë evropiane, të cilat zakonisht janë më simpatike ndaj palestinezëve sesa administratat e SHBA-së, ishin shumë kritikë ndaj sulmit.

Biden tha se ai i telefonoi Netanyahu për të “dënuar pa mëdyshje” “sulmet e tmerrshme... të tmerrshme dhe të vazhdueshme në Izrael”.

”I kam bërë të qartë kryeministrit Netanyahu se jemi të gatshëm të ofrojmë të gjitha mjetet e duhura të mbështetjes për qeverinë dhe popullin e Izraelit”, tha Biden në një deklaratë.

“Terrorizmi nuk justifikohet

kurrë. Izraeli ka të drejtë të mbrojë veten dhe popullin e tij. Shtetet e Bashkuara paralajmërojnë kundër çdo pale tjetër armiqësore ndaj Izraelit që kërkon përfitime në këtë situatë. Mbështetja e administratës sime për sigurinë e Izraelit është e fortë dhe e palëkundur”, shtoi presidenti.

“Ne qëndrojmë në solidaritet me qeverinë dhe popullin e Izraelit”, tha Blinken në një deklaratë “dhe shprehim ngushëllimet tona për jetët izraelite të humbura në këto sulme”.

“Ne do të mbetemi në kontakt të ngushtë me partnerët tanë izraelitë. Shtetet e Bashkuara mbështesin të drejtën e Izraelit për të mbrojtur veten”, shtoi ai.

Sekretari i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III tha se Pentagoni do të “punojë për të siguruar që Izraeli të ketë atë që i nevojitet për të mbrojtur veten dhe për të mbrojtur civilët nga dhuna dhe terrorizmi pa dallim”.

Presidenti Begaj pret homologun e tij Francez, Emmanuel Macron

Presidenti i Republikës Sh.T.Z. Bajram Begaj priti sot Presidentin e Republikës së Francës, Sh.T.Z. Emmanuel Macron, si dhe delegacionin që e shoqëron.

Kjo vizitë është një ngjarje historike në marrëdhëniet midis dy vendeve tona, pasi është vizita e parë zyrtare e një Presidenti të Francës në Shqipëri. Përgjatë takimit kokë më kokë, Presidenti Begaj nënvizoi se kjo vizitë demonstroi interesin e përbashkët për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, si dhe në drejtim të paqes, sigurisë, dhe zhvillimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Pjesë e bisedimeve me Presidentin Macron ishin edhe integrimi evropian i Shqipërisë dhe zhvillimet në rajon. Presidenti Begaj shprehu mirënjohjen, për mbështetjen e vyer që Franca dhe Presidenti Macron i kanë dhënë e i japin procesit të zgjerimit dhe të integritit evropian të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Procesit të Berlinit. Ai gjithashtu vlerësoi iniciativën e ndërmarrë një vit më parë nga Presidenti Macron, për lançimin e Komunitetit Politik Evropian, si një iniciativë që i jep më shumë mundësi Shqipërisë dhe vendeve të tjera kandidate në Bashkimin Evropian, të kenë më shumë akses në projektet e BE-së, veçanërisht në fushën e shkëmbimeve universitare dhe studentore.

Presidenti Begaj falenderoi



gjithashtu Presidentin Macron, për kontributin në mbështetje të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht përmes planit të quajtur franko-gjerman, duke nënvizuar nevojën e mbështetjes së mëtejshme të këtij dialogu, por edhe të nevojës së dënimit dhe të çkurrimit të akteve të dhunës dhe të provokimeve në komunat e Veriut të Kosovës. “Kosova është vend sovran dhe i pavarur, dhe



akte terroriste si ajo e Banjskës në Zveçan (24 shtator 2023), janë të papranueshme e të dënueshme për sigurinë e saj, por edhe të rajonit e të mbarë kontinentit evropian.”

Presidenti Begaj vlerësoi se pesë vjet pas nënshkrimit të Deklaratës së Partneritetit Strategjik midis dy vendeve, marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Francës kanë hyrë në një fazë të re e shumë dinamike.

Presidenti Begaj shprehu kënaqsinë e tij se përtej marrëdhënieve të konsoliduara kulturore midis dy vendeve, interesi i madh i kompanive franceze, veçanërisht në fushën e energjisë së rinovueshme, por jo vetëm, po i çon marrëdhëniet në një nivel tjetër, edhe më të lartë. “Jam besimplotë që projektet e parqeve fotovoltaike në Karavasta dhe Spitallë, do të ndiqen edhe nga projekte të tjera të mëdha nga investitorët francezë,” – tha në një mesazh të shpërndarë për mediat Presidenti Begaj.

Presidenti i Kroacisë, Zoran Milanović: Jam i vetmi joshqiptar, që bëj thirrje për njohjen e shtetit të Kosovës



“Fakt është që jam në mes të vetmëve, apo që nuk është shqiptar, që këtë gjë e kam bërë dhe në New York dhe kjo ka të bëjë me thirrjen për të pranuar Kosovën. Kjo mua më tregon faktin të cilin e tërë Evropa e njeh, por nuk dëshiron ta përmend. Kjo nuk është e sinqertë dhe kjo është dëmshme për ne në një afat më të gjatë”,

Presidenti i Kroacisë, Zoran Milanović



Presidenti i Kroacisë, Zoran Milanović ripërsëriti sot thirrjen për njohjen e Kosovës, ndërsa u shpreh se mund të jetë ndër të vetmit joshqiptarë që e shtron këtë çështje në takime ndërkombëtare.

Milanović po zhvillon një vizitë zyrtare dyditore në Tiranë, në kuadër të së cilës u prit sot nga Presidenti Bajram Begaj me të cilin doli edhe në një konferencë të përbashkët për shtyp.

“Fakt është që jam në mes të vetmëve, apo që nuk është shqiptar, që këtë gjë e kam bërë dhe në New York dhe kjo ka të bëjë me thirrjen për të pranuar Kosovën. Kjo mua më tregon faktin të cilin e tërë Evropa e njeh, por nuk dëshiron ta përmend. Kjo nuk është e sinqertë dhe kjo është dëmshme për ne në një afat më të gjatë”, theksoi ai.

Sipas Milanović, “përderisa koha kalon, këto pengesa bëhen më të ndërlikuara”.

“Serbia ka ngecur në negociata në fillim. Ishte nisur në një vrull më të madh, por siç duket për ata kjo nuk ishte prioritet. Kanë gjëra të tjera dhe

natyrisht që ata e kanë përkrahur kryengritjen e armatosur në Kosovë dhe ndaj saj nuk ka pasur një përgjigje të duhur. Nuk e di se Shqipëria çfarë tjetër mund të bënte nga ajo që ka bërë”, theksoi ai.

Milanović u shpreh se është dëshmitar i zhvillimit të Shqipërisë në shumë aspekte, por sipas tij, “ky progres nuk është përcjellë me reagimet e duhura institucionale të BE-së”.

Presidenti kroat u shpreh se Shqipëria është në NATO, dhe avancimi drejt një aleance tjetër, BE-së, e cila është shumë më komplekse, aty Shqipëria nuk ka mundur të bëjë as hapin e parë”. “Kjo flet shumë për BE dhe për prioritetet tona”, tha ai.

“Këtë rrugë e kaluar Kroacia me sukses dhe hap pas hapi. Si vendi me përvojën më të freskët për këtë rrugë, për Shqipërinë mund të jemi këshilltarët më pak të mirë në këtë proces sepse jemi të fundit që jemi anëtarësuar. Tani priten disa pika të reja që do të rrjedhin për të shtyrë më tej këtë proces”, tha Milanović.

Liderët evropianë: Kosova t'i nisë procedurat për asociacionin, Serbia njohjen "de facto"

Kosovës i bëhet thirrje për nisje të procedurave për themelimin të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, ndërsa Serbisë që de facto ta njohë shtetësinë e Kosovës, shkruan Kosovapress.

Kështu është thënë në një komunikatë të publikuar të premten nga presidenti francez, Emmanuel Macron, kancelari gjerman, Olaf Scholz, kryeministrja italiane, Giorgia Meloni.

Ata e kanë publikuar këtë komunikatë një ditë pas takimeve që kanë zhvilluar ndaras me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin serb, Aleksandar Vuçiq në Bruksel, në margjina të saminit të BE-së.

